

RREGULLORJA E EDUKIMIT NË VAZHDIM NË PSIKOLOGJI

Synimi i Rregullores së Edukimit në Vazhdim është rritja e vazhdueshme e njohurive dhe zhvillimi i aftësive profesionale të psikologëve, në funksion të përmirësimit të shërbimit të psikologjisë në vend.

Komisioni i Edukimit në Vazhdim në Psikologji (KEVP) është organ i Urdhrit të Psikologut përgjegjës për:

- planifikimin, bashkërendimin dhe zbatimin e programeve të formimit të vazhdueshëm të psikologëve;
- bashkërendimin e punës dhe realizimin e procesit të akreditimit të programeve dhe veprimtarive të edukimit në vazhdim në psikologji;
- mbarëvajtjen e procesit të rilicencimit të psikologëve;
- realizimin e studimeve të vlerësimit të nevojave për formim të vazhdueshëm për të gjithë specialitetet e psikologjisë, në përgjithësi;
- hartimin dhe/ose miratimin e programeve të aktiviteteve të edukimit profesional fillestar ose vazhdueshëm, kur nga aktet ligjore e nënligjore, kërkohet që këto aktivitete të kryhen drejtpërdrejt nga Urdhri i Psikologut.

KRITERET, STANDARDET DHE PROCEDURAT PËR RILICENCIMIN E PSIKOLOGËVE

1. Standardet e rilicencimit

1.1 Psikologu e planifikon vetë pjesëmarrjen në aktivitete të edukimit në vazhdim, bazuar në nevojat e tij profesionale, nevojat e identifikuar nga institucioni ku ushtron aktivitetin dhe kompetencat e dëshiruara.

1.2 Psikologu zgjedh ato aktivitete që bazohen në nevojat e perceptuara nga ai vetë, si dhe në ato që janë identifikuar nga vlerësime të tjera.

1.3 Aktiviteti i edukimit në vazhdim duhet të ketë lidhje me specialitetin, rolin profesional dhe përgjegjësitë që ka psikologu në pozicionin aktual të punës.

1.4 Psikologu duhet të jetë i angazhuar për të ruajtur profesionalizmin gjatë gjithë kohës së ushtrimit të profesionit dhe në kujdesin që ofron, përmes përmirësimit të vazhdueshëm.

1.5 Psikologu synon ta integrojë procesin individual të të mësuarit në atë të ekipit me të cilin punon, grupe të kolegëve apo komunitetin e gjerë.

1.6 Urdhri i Psikologut ndihmon në çdo rast psikologun, në rastet kur duhet t'i krijohen mundësitë dhe kushtet e përshtatshme nga strukturat dhe institucionet ku është i punësuar për ndjekjen e aktiviteteve të edukimit në vazhdim, duke lehtësuar pjesëmarrjen e tij/saj në këto aktivitete dhe duke ndërmjetësuar, kur është e nevojshme, mes tij dhe institucioneve.

2. Numri i krediteve të kërkuara

2.1 Kreditet e edukimit në vazhdim janë tregues të sasisë dhe cilësisë së ndjekjes së aktiviteteve të edukimit në vazhdim nga profesionistët e psikologjisë.

2.2 Regjistrimi i krediteve kryhet nga një specialist i posaçëm i Urdhrit të Psikologut në regjistrin elektronik të anëtarësisë, i cili bëhet publik.

2.3 Brenda një cikli 5-vjeçar, psikologët duhet të mbledhin një numër jo më të vogël se 100 kredite të edukimit në vazhdim. Numri i nevojshëm për rilicencim i krediteve të edukimit në vazhdim, që një psikolog duhet të mbledhë, sipas kategorive të aktiviteteve, është si më poshtë:

2.3.1 Kreditet e përfituara nga aktivitete të edukimit në vazhdim, të lidhura drejtpërdrejt me fushën e kompetencës apo fushën ku ushtrn profesionin psikologu, duhet të përbëjnë të paktën 50% të numrit të përgjithshëm të krediteve të raportuara nga psikologu;

2.3.2 Kredite të përfituara nga aktivitete të edukimit në distancë duhet të përbëjnë jo më shumë se 50% të numrit të përgjithshëm të krediteve të raportuara.

2.3.4 Kredite të përfituara nga aktivitete të vetëraportuara përllogariten deri në 20% të numrit të përgjithshëm të krediteve të raportuara nga psikologu.

2.3.5 Numri vjetor minimal i detyrueshëm i krediteve të edukimit në vazhdim për psikologët është 10 kredite. Në rast mosplotësimi të numrit vjetor minimal të krediteve, psikologu duhet ta plotësojë atë brenda 6 mujorit të parë të vitit pasardhës. Ky afat mund të shtyhet nga KEVP, vetëm për arsye madhore të provuara me dokumentacion shoqëruës. Mos përmbushja e këtij detyrimi sjell pezullimin e së drejtës së ushtrimit të profesionit deri në përmbushje të tij.

2.3.6 Pjesa tjetër e krediteve të nevojshme përcaktohet nga zgjedhja e lirë e psikologut, në bazë të nevojave individuale.

2.4 Në përmbushje të kriterëve të mësipërme, psikologu pajiset me Lejen e re të Ushtrimit të Profesionit.

3. Aktivitete të edukimit në vazhdim dhe kreditet përkatëse

3.1 Aktivitete të edukimit në vazhdim të akredituara paraprakisht

Aktivitetet e edukimit në vazhdim, që akreditoohen nga KEVP-ja, mund të jenë:

3.1.1 “Konferenca”, një aktivitet 1-5 ditorë për një temë të caktuar, zakonisht e zhvilluar nga institucione publike ose private, ku mbahen një seri leksionesh nga ekspertë të fushës, e organizuar në seanca plenare dhe/ose seanca paralele. Qëllimi i konferencës është të shtojë njohuritë e audiencës profesionale, kryesisht mbi të rejat e fundit të profesionit, në lidhje me praktikën përkatëse në fushën e psikologjisë;

3.1.2 “Trajnimi”, një aktivitet edukues (nga 1 deri 25 ditë efektive, pavarësisht shpërndarjes së tyre në kohë), me qëllim përfundimin e njohurive, aftësive dhe shprehjeve praktike që nevojiten për të përmbushur detyrat dhe misionin e ushtrimit të profesionit në mënyrë të kënaqshme. Ai përfshin përdorimin e metodave të ndryshme dhe jo thjesht mbajtjen e leksioneve.

3.1.3 “Seminari”, një aktivitet mësimor, ku një grup i vogël pjesëmarrësish mësojnë rreth një çështjeje të caktuar dhe marrin pjesë aktivisht, nëpërmjet diskutimit të artikujve të caktuar, prezantimit të studimeve të ndryshme, pyetjeve dhe debateve;

3.1.4 “Workshop”, një aktivitet i zhvilluar me një grup të vogël pjesëmarrësish, të cilët përfshihen aktivisht në diskutime, zgjidhje problemesh ose në kryerjen e një teknike, procedure apo manipulimi me ndihmën e një eksperti. Qëllimi është që pjesëmarrësit të mësojnë, duke provuar, gabuar dhe korrigjuar vetë ose me ndihmën e të tjerëve, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për praktikën e tyre të përditshme;

3.1.5 “Prezantimi i një leksioni”, një aktivitet që nxit edukimin në vazhdim profesional. Leksioni është një prezantim me gojë, nga një profesionist i kualifikuar dhe me përvojë në fushën përkatëse, i një teme të caktuar, të përgatitur mirë, për rreth 50 deri në 90 minuta, i shoqëruar me pyetje-përgjigje. Aftësitë komunikuese, prezantuese dhe ekspertiza janë cilësitë kryesore të një lektori të mire. Leksionet mund të jenë të organizuara edhe në “Cikle leksionesh”.

3.1.6 “Grup rishikimi”, një aktivitet në grup të vogël (5-10 vetë), ku profesionistët e të njëjtit specialitet ose shërbim mblidhen për të diskutuar për çështje kryesore që lidhen me praktikën e tyre profesionale, me cilësinë e shërbimit dhe zgjidhjet e mundshme. Qëllimi kryesor i grupeve të rishikimit është shkëmbimi i përvojave dhe vlerësimi i punës së njëri-tjetrit, zgjidhja e problemeve praktike, hartimi i udhëzuesve për të përmirësuar shërbimin. Grupet e rishikimit mblidhen rregullisht dhe drejtohen nga një drejtues grupi;

3.2 Për aktivitetet me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë:

3.2.1 Kur numri i pjesëmarrësve është deri në 100 veta, përlllogaritja e krediteve kryhet sipas kriterit “një kredit për çdo orë”. Kur numri i pjesëmarrësve është 101–200 veta, përlllogaritja e krediteve kryhet sipas kriterit “0.7 kredite për çdo orë”, ndërsa për aktivitete me mbi 200 pjesëmarrës zbatohet kriteri “0.5 kredite për çdo orë”; Në rastet e aktiviteteve që zhvillohen në salla paralele, përlllogaritja e numrit të pjesëmarrësve bëhet veçmas për çdo sallë.

3.2.2 Për trajnime të individualizuara, që përfshijnë fitimin e njohurive dhe të aftësive në kryerjen e procedurave apo të teknikave të reja me jo më shumë se 5 pjesëmarrës, përlllogaritja e numrit të krediteve bëhet sipas kriterit “1.5 kredite për çdo orë”.

3.2.3 Përlllogaritja bazohet vetëm në kohëzgjatjen efektive, që përfshin orët reale të mësimdhënies dhe të ndërveprimit me pjesëmarrësit, duke mos përfshirë pushimet ndërmjet prezantimeve, seancën prezantuese të aktivitetit etj. Kohëzgjatja e aktivitetit nuk duhet të kalojë 10 orë në ditë;

3.2.4 Numri maksimal i krediteve, që bazohet në orët efektive, nuk duhet të kalojë 6 kredite në ditë. Ndërsa, mund të bëhet një rritje 0.3 kredite për çdo orë për përmbushjen e secilit prej këtyre kriterëve:

- i. numri i parashikuar i pjesëmarrësve është deri në 25;
- ii. përdorimi i metodologjisë interaktive, për të paktën, 50 pjesëmarrës;
- iii. tema e aktivitetit është në përputhje me fushat prioritare të miratuara nga KEVP-ja.

3.2.5 Aktivitetet e edukimit në distancë si parim akreditoohen sipas kriterit “një kredit për çdo orë” të parashikuar. Për aktivitetet E-Learning, në rast se platforma teknologjike përdor hapësira bashkëpunimi ndërmjet pjesëmarrësve (chat, forum) dhe kanale interaktive sinkrone dhe/ose asinkrone (brenda 48 orësh) me lektorët/tutorët, mund të bëhet një rritje 0.5 kredite për çdo orë. Për aktivitetet e edukimit në distancë sinkron (të njëkohshëm), përlllogaritja e krediteve bëhet sipas kriterit “1.5 kredite për çdo orë”.

3.2.6 Në rastet kur psikologu ka marrë pjesë si lektor/trajnues pa pagesë në një aktivitet të edukimit vazhdues, atëherë, kreditet që regjistrohen përlllogariten në bazë të kohëzgjatjes së leksioneve të kryera nga lektori dhe kriterit 1 orë = 1.5 kredite, por jo më shumë se 6 kredite në ditë. Në rastet kur psikologu ka marrë pjesë si lektor/trajnues me pagesë në një aktivitet të edukimit vazhdues, atëherë, kreditet që regjistrohen përlllogariten në bazë të kohëzgjatjes së leksioneve të kryera nga lektori dhe kriterit 1 orë = 0.5 kredite, por jo më shumë se 2 kredite në ditë.

4. Aktivitete të edukimit në vazhdim të paakredituara paraprakisht

4.1 “Aktivitet kërkimor/studimor”, përfshirja e psikologut në punë kërkimore, në shkrime artikujsh apo materialesh të tjera profesionale dhe shkencore është një formë tjetër e edukimit në vazhdim.

4.2 Regjistrimi i krediteve nga botimet në revista shkencore, botim i teksteve mësimore, recensimi i botimeve, supervizimi i praktikave profesionale, si dhe postera e abstrakte. Në këtë rast, kërkesa për njohjen dhe regjistrimin e krediteve duhet bërë individualisht nga psikologu, pranë KEVP-së. Dokumentet që duhet të paraqiten në rastet e botimit të artikujve, kapitujve të librave ose librave, janë fotokopje të kapakut të revistës ose të librit, si dhe fotokopja e faqes së parë të artikullit ose të kapitullit. Përlllogaritja e krediteve për aktivitetet e kësaj kategorie bëhet si më poshtë:

Lloji i aktivitetit	Nr. krediteve
Botim artikulli në revistë shkencore	
Revistë shkencore e indeksuar në regjistër ndërkombëtar dhe me faktor impakti	10 -20
Revistë shkencore e indeksuar në regjistër ndërkombëtar pa faktor impakti	7-15
Revistë shkencore e paindeksuar në regjistër ndërkombëtar dhe pa faktor impakti	2-7
Botim i teksteve mësimore	
Tekst pasuniversitar	25 - 50
Monografi	50
Tekst mësimor për studentët e psikologjisë	20 -30
Recensimi i botimeve	
Recensimi i tekstit mësimor	15
Recensimi i artikullit	5
Supervizimi i praktikave profesionale	
Supervizor me ekspierncë profesionale deri në 10 vjet	10
Supervizor me ekspierncë profesionale 10 deri në 20 vjet	15
Supervizor me ekspierncë profesionale mbi 20 vjet	20
Abstrakt/Poster i botuar në librin e përmbledhës të një:	
Aktivitet i edukimit në vazhdim jashtë vendit	10-20
Aktivitet i edukimit në vazhdim brenda vendit	5-10

Limiti: Pavarësisht nga numri i abstrakteve ose posterave të botuara brenda të njëjtit aktivitet, vlerësimi bëhet vetëm për një të tillë.

4.2 Regjistrimi i krediteve nga aktivitete të vetëraportuara kryhet në mënyrë individuale nga psikologu pranë KEVP-së, shoqëruar me dokumentacionin provues, sipas formatit të kërkuar nga KVEP.

4.3 Regjistrimi i krediteve nga aktivitete të edukimit në vazhdim të akredituara nga institucione të tjera jashtë vendit, bëhen pas kërkesës së psikologut për njohjen dhe regjistrimin e këtyre krediteve në KEVP, shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar.

5.1 Regjistrimi i krediteve nga aktivitete të edukimit në vazhdim të akredituara paraprakisht nga KEVP-ja.

5.1.1 Në rastet kur psikologu merr pjesë në një aktivitet të edukimit në vazhdim të akredituar paraprakisht nga KEVP-ja, atëherë raportimi i krediteve përkatëse është përgjegjësi e ofruesit të aktivitetit, i cili duhet të dorëzojë pranë KEVP-së listën e pjesëmarrësve në aktivitet. Regjistrimi i krediteve bëhet nga një specialist i posaçëm i administratës së Urdhrit të Psikologut në dosjet individuale elektronike të të gjithë pjesëmarrësve.

5.1.2. Ofruesi i akredituar përcakton kreditet e edukimit në vazhdim, bazuar në në këtë rregullore, për pjesëmarrjen efektive (pa pushimet e ndërmjetme).

5.1.3 Një aktivitet i edukimit në vazhdim nuk mund të vlerësohet me më shumë se 40 kredite nga ofruesi i akredituar.

5.1.4 Një aktivitet i edukimit në vazhdim nuk mund të vlerësohet me më shumë se 8 kredite në ditë nga ofruesi i akredituar.

5.1.4 Kreditet e edukimit në vazhdim jepen nga ofruesi, pasi ai ka kryer vlerësimin e marrjes së njohurive të duhura nga ana e pjesëmarrësit.

6. Afatet kohore të regjistrimit të krediteve të pa akredituara paraprakisht nga KVEP

6.1 Për regjistrimin e krediteve të përfituara nga aktivitete të pa akredituara paraprakisht nga KVEP, psikologu duhet të aplikojë për njohjen dhe për regjistrimin e krediteve pranë KEVP-së para datës 15 dhjetor dhe të plotësojë formularin përkatës një herë për secilin vit kalendarik.

6.3 KEVP-ja duhet të kryejë procedurat e njohjes dhe regjistrimit të krediteve në dosjen individuale të psikologut brenda një afati kohor jo më të gjatë se 60 ditë nga data e dorëzimit të dokumentacionit të nevojshëm nga ana e ofruesit ose psikologut.

6.4 I gjithë dokumentacioni i programit të rilicencimit duhet të ruhet nga UP- ja sipas legjislacionit në fuqi për arkivat dhe për mbrojtjen e të dhënave personale.

III. RILICENCIMI I PSIKOLOGËVE

7.1 Njoftimi mbi statusin e licences

Në fund të secilit cikël 5-vjeçar të programit të rilicencimit, UP-ja njofton në faqen zyrtare psikologët për përmbushjen e kërkesave për rilicencim dhe njofton, kur është e nevojshme, institucionet për statusin e licences të psikologëve të punësuar në to.

7.2 Ankimi

Psikologu ka të drejtë të ankohet pranë KVEP-së për parregullsi në njohjen dhe në regjistrimin e krediteve brenda 30 ditëve nga data e publikimit të rezultateve.

7.3 Psikologët, të cilët nuk plotësojnë kërkesat për rilicencim, i nënshtrohen provimit të rilicencimit, i cili organizohet nga Urdhri i Psikologut sipas modaliteteve dhe fondit të pyetjeve me të cilat kryhet provimi i shtetit. Rregullorja e provimit të rilicencimit miratohet nga Këshilli Kombëtar.

IV. MBI PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE, TË KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË AKREDITIMIT TË OFRUESVE TË AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM PËR PROFESIONISTËT E PSIKOLOGJISË

8.1. Ofrues të akredituar të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm janë të gjitha strukturat publike ose private, akademike ose joakademike, fitimprurëse ose jofitimprurëse, që kanë ekspertizën dhe eksperiencën e duhur në organizimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim në fushën e psikologjisë dhe që plotësojnë standardet e kriteret e paraqitura në vijim në këtë rregullore.

8.2. Akreditimi i një ofruesi është procesi i miratimit të tij si ofrues i akredituar i aktiviteteve të edukimit në vazhdim, bazuar në procedurat dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

8.3. Organi përgjegjës për procesin e akreditimit të ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim është KEVP

8.4. KEVP-ja ka këto përgjegjësi:

8.4.1 Merr në dorëzim dhe shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga ofruesi, koordinon me ofruesin për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar dhe kryen verifikime/inspektime për të garantuar që situata në terren përputhet me kriteret e përcaktuara dhe me deklaratimet e bëra nga ofruesi. KEVP-ja bën vlerësimin e aplikimit për akreditim të ofruesit dhe harton raportin e vlerësimit;

8.4.2 Monitoron në vazhdimësi ofruesin e akredituar dhe aktivitetet e edukimit në vazhdim të organizuara prej tij. KEVP-ja, nëpërmjet personave të autorizuar nga kryetari i këtij organi, duhet të kryejë monitorime, të paktën për 30 për qind të aktiviteteve të edukimit në

vazhdim të çdo ofruesi të akredituar, si dhe verifikim të përmbushjes së kriterëve të tjera, të paktën, një herë në vit;

8.4.3 Në rastet kur vihen re shkelje të kriterëve, në varësi të formës dhe rëndësisë së tyre, merr masën e pezullimit të përkohshëm ose të anulimit të akreditimit të ofruesit të akredituar;

8.4.4 Publikon listën e ofruesve të akredituar dhe statusin e përditësuar të tyre.

V. STANDARDET E AKREDITIMIT TË OFRUESVE

9.1. Ofruesi duhet të demonstrojë një proces planifikimi të aktivitetit, i cili gërsheton nevojat e identifikuar për edukim në vazhdim me rezultatet e parashikuara të aktivitetit.

9.2 Ofruesi duhet të përdorë të dhëna të bazuara në vlerësimin e nevojave për hartimin dhe planifikimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim.

9.3 Ofruesi duhet të komunikojë qëllimin dhe objektivat e aktivitetit, në mënyrë që psikologët pjesëmarrës të jenë në dijeni të tyre para ofrimit të aktivitetit.

9.4 Objektivat e aktiviteteve të edukimit në vazhdim të shërbejnë për të orientuar hartimin e aktivitetit sa më pranë nevojave reale për zhvillim profesional të profesionistëve të psikologjisë.

9.5 Objektivat e aktivitetit të edukimit në vazhdim duhet të jenë objektiva të zhvillimit të njohurive dhe aftësive:

9.5.1 tekniko-profesionale individuale, sipas fushave të veçanta të çdo kategorie apo specialiteti (objektiva të nivelit individual);

9.5.2 për rritjen e cilësisë, efikasitetit, efikasitetit dhe siguri më të lartë, në raport me institucionet ose shërbimet ku profesionistët e psikologjisë punojnë;

9.6 Ofruesi duhet të bëjë një lidhje të drejtpërdrejtë e domethënëse të objektiveve të paraqitura me përmbajtjen e programit dhe teknikat pedagogjike për çdo aktivitet të planifikuar prej tij.

9.7 KEVP-ja mund të kushtëzojë ofruesin e akredituar në hartimin e objektiveve për aktivitete të caktuara, në varësi të përparësive dhe nevojave.

9.8 Ofruesi duhet të garantojë pjesëmarrjen reale të psikologëve në aktivitetin e edukimit në vazhdim. Kjo mund të realizohet në mënyra të ndryshme, si nënshkrim për pjesëmarrje, verifikim elektronik i pjesëmarrjes, formular vlerësimi për aktivitetin i nënshkruar nga pjesëmarrësi.

9.9 Ofruesi duhet të garantojë vlerësimin e cilësisë së perceptuar të aktivitetit nga pjesëmarrësit, nëpërmjet një formulari të vlerësimit të aktivitetit.

9.10. Ofruesi duhet të sigurojë cilësinë e aktiviteteve, me anë të vlerësimit nga ekspertë të pavarur të fushave përkatëse të psikologjisë, si dhe të vlerësojë shkallën e përvetësimit të njohurive nga ana e pjesëmarrësve, në fund të aktivitetit.

9.11 Ofruesi duhet t'i pajisë psikologët me certifikatën e pjesëmarrjes, ku duhet të jenë të paraqitura edhe kreditet përkatëse.

VI. KRITERET PËR AKREDITIM TË PËRKOSSHËM DHE AFATGJATË

10.1 Ofruesi duhet të ketë të përcaktuar “ofrimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim për psikologët” në objektin e veprimtarisë së tij.

10.2. Ofruesi duhet të ushtrojë veprimtarinë e tij në ambiente me sipërfaqe jo më pak se 50 m².

10.2.1. Ofruesi duhet të zhvillojë aktivitetet e edukimit në vazhdim në mjedise:

- me ajër të kondicionuar;
- me ndriçim të plotë dhe të garantuar edhe për raste emergjente;
- të pajisura me aparaturat/mjetet e nevojshme për realizimin e aktivitetit;
- me normativa të shfrytëzueshme prej 7.5 - 8.0 m²/pjesëmarrës. Bazuar në këtë normë, ofruesi deklaron numrin maksimal të pjesëmarrësve të mundshëm. (Përjashtim nga kjo normativë bëhet vetëm për konferencat.)

10.3. Ofruesi duhet të provojë një historik të organizimeve korrekte, në përputhje me kriteret dhe standardet e edukimit në vazhdim, siç përcaktohen në këtë rregullore.

10.4. Ofruesi duhet të provojë besueshmëri ekonomike, financiare, nëpërmjet bilancit të vitit të fundit.

10.5 Ofruesi duhet të provojë që ka burimet njerëzore që garantojnë stabilitet të veprimtarisë së tij dhe cilësi në organizimin e menaxhimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim. Këtu duhet të përshihen:

- 10.5.1 koordinatori shkencor përgjegjës për konceptimin dhe planifikimin e aktiviteteve;
- 10.5.2 komiteti shkencor, që bën miratimin e planit të aktiviteteve, përfshirë programet dhe lektorët. Komiteti shkencor duhet të ketë, minimalisht, tre pjesëmarrës, nga të cilët dy persona me kohë të plotë: një profesionist kompetent për edukimin në vazhdim, përgjegjës për zbatimin dhe sigurimin e mbarëvajtjes së aktiviteteve, dhe një person përgjegjës për menaxhimin/arkivimin e të dhënave dhe informacionit.

VII. PROCESI I AKREDITIMIT

11.1. Ofruesi, bazuar në fushën e tij të ekspertizës dhe eksperiencës, mund të aplikojë për akreditim të kufizuar ose të pakufizuar. Akreditimi i kufizuar mund të kërkohet për specialitete specifike të psikologjisë, për kategori të veçanta të psikologëve ose për lloje specifike aktiviteteve të edukimit në vazhdim, si aktivitete institucionale, aktivitete të edukimit në distance, etj.

11.2. Procesi i akreditimit fillon me aplikimin për akreditim të përkohshëm. Ofruesi duhet të dorëzojë në KEVP kërkesën për akreditim të përkohshëm dhe dokumentacionin që provon përmbushjen e kriteve të përcaktuara në këtë rregullore.

11.3 KEVP-ja, brenda 3 muajve nga data e marrjes në dorëzim të aplikimit dhe dokumentacionit shoqërues, duhet:

- 11.3.1 të verifikojë plotësimin dhe vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga ofruesi;
- 11.3.2 të kërkojë dokumentacione plotësuese, nëse është rasti, apo të kryejë monitorime (inspektime) në vendndodhjen e ofruesit.

11.4. Akreditimi i përkohshëm është i vlefshëm për një periudhë 12-mujore.

11.5 Pas një periudhe prej 6 muajsh, nga marrja e akreditimit të përkohshëm, ofruesi mund të aplikojë për akreditim afatgjatë, duke përditësuar dokumentacionin e dorëzuar gjatë akreditimit të përkohshëm dhe duke e plotësuar atë me një raportim të aktiviteteve të edukimit në vazhdim të kryera gjatë kësaj periudhe.

11.6. KEVP-ja, brenda 3 muajve nga data e aplikimit për akreditim afatgjatë,:

11.6.1 vlerëson dokumentacionin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim, të zhvilluara nga ofruesi gjatë periudhës së akreditimit të përkohshëm, dhe verifikon përmbushjen e kriterëve të tjera;

11.6.2 kryen monitorime në mjediset e ofruesit, për të verifikuar përmbushjen e kriterëve që lidhen me to.

11.6.3 merr vendim për akreditim të përkohshëm/ose jo të ofruesit.

11.6.4 harton një raport vlerësimi me gjetjet e konstatuara nga shqyrtimi i dokumentacionit e nga monitorimet dhe merr vendim për akreditimin afatgjatë/ose jo të ofruesit, i cili është i vlefshëm për një periudhë prej 3 vjetësh.

11.7. Për rinovimin e akreditimit afatgjatë, ofruesi duhet të dorëzojë në KEVP aplikimin për rinovim të akreditimit, jo më vonë se 8 muaj nga data e mbarimit të tij.

11.8. KEVP-ja, brenda 3 muajve nga data e aplikimit për rinovim të akreditimit të gjatë, kryen detyrat e përcaktuara, harton raportin e vlerësimit dhe merr vendim për akreditim/ose jo të ofruesit për një periudhë prej 3 vjetësh.

VIII. PROCESI I MONITORIMIT TË OFRUESIT TË AKREDITUAR

12.1. Çdo vit, KEVP-ja duhet të kryejë monitorime të paktën 30 për qind të aktiviteteve të edukimit në vazhdim të organizuara nga ofruesi i akredituar, për të garantuar zbatimin e kriterëve gjatë zhvillimit të aktiviteteve.

12.2. KEVP-ja kryen verifikim të përmbushjes së kriterëve të tjera, të paktën një herë në vit.

12.3 Pas monitorimit dhe/ose verifikimit, KEVP-ja harton një raport monitorimi/verifikimi, ku paraqiten gjetjet e monitorimit/verifikimit, shkeljet e vërejtura, rekomandimet për eliminimin e këtyre shkeljeve dhe afatet kohore respektive. Ky raport i dorëzohet, gjithashtu, edhe ofruesit të akredituar.

IX. REFUZIMI, PEZULLIMI DHE ANULIMI I AKREDITIMIT

13.1. Në rastet kur KEVP-ja nuk i vlerëson të përmbushura kriteret dhe standardet e kërkuara, merr vendim për refuzimin e kërkesës për akreditim të këtij ofruesi dhe ia bën atij me dije, duke paraqitur motivet e refuzimit.

13.2 Në rastet e refuzimit të kërkesës për akreditim, ofruesi ka të drejtë të riaplikojë pas një periudhe prej 3-muajsh.

13.3 Në rast se KEVP-ja, gjatë procesit të monitorimit të ofruesit të akredituar, konstaton shkelje të kriterëve dhe standardeve të edukimit në vazhdim, merr vendim për:

13.3.1 pezullimin e përkohshëm të akreditimit, për një periudhë deri në 12 muaj;

13.3.2 anulimin e akreditimit, në rastet e shkeljeve të rënda apo në rast të mospërbushjes së standardeve, pas periudhës së pezullimit.

13.4. Gjatë procesit të monitorimit konsiderohen shkelje të rënda:

- moszhvillimi i aktivitetit të deklaruar, pa njoftim paraprak në KEVP;
- shkeljet e kriterëve për mbështetjen dhe transparencën financiare, sipas kësaj rregulloreje;
- konstatimi i më shumë se tre shkeljeve të lehta;

13.5. Gjatë procesit të monitorimit konsiderohen shkelje të lehta:

- ndryshime në programin e aktivitetit, të cilat cenojnë cilësinë e tij dhe ndikojnë në përlllogaritjen e krediteve të miratuara;
- mosraportimi i konflikteve të interesit të organizatorëve ose/dhe trainuesve në aktivitet;
- përdorimi i aktivitetit për promovim personal ose tregtar;
- keqpërdorimi i emrit të institucionit akreditues dhe i krediteve të njohura prej tij;
- vlerësimi negativ i shumicës së pjesëmarrësve për organizimin e aktivitetit, përmbajtjen e temave të veçanta ose nivelin pedagogjik të paraqitjes së këtyre temave;

13.6 Në rastet e anulimit të akreditimit, ofruesi ka të drejtë të riaplikojë pas një periudhe prej 12-muajsh.

X. E DREJTA E ANKIMIT

Ofruesit e aktiviteteve të edukimit në vazhdim kanë të drejtë të ankohen pranë Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut për vendimin e akreditimit brenda 30 ditëve, nga momenti i marrjes dijeni për të. Çdo ankesë duhet të paraqitet me shkrim dhe të shoqërohet me të dhëna e argumente që mbështesin ankimin. Këshilli Kombëtar ngre një komision të posaçëm që shqyrton raportin e vlerësimit dhe, kur ankesat janë të mbështetura, i reflekton në raportin përfundimtar dhe në vendimin e akreditimit.

XI. KRITERET, STANDARDET DHE PROCEDURAT E PROCESIT TË AKREDITIMIT TË AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM PËR PSIKOLOGËT

14. Procesi i akreditimit

14.1 Aplikimi për akreditim

14.1.1 Aplikimi për akreditimin e aktivitetit të edukimit në vazhdim, për profesionistët e psikologjisë, duhet të bëhet pranë Urdhrit të Psikologut, nga ofruesi/t e aktivitetit, jo më vonë se 60 ditë nga data e planifikuar për zbatimin e tij. Aplikimi për akreditim shoqërohet me pagesën e tarifës, sipas kësaj rregulloreje.

14.1.2 Për akreditimin e aktiviteteve që janë akredituar më parë nga KEVP-ja, ofruesi ka detyrimin të dërgojë në KEVP një njoftim me shkrim, të shoqëruar me programin e aktivitetit, të paktën 7 ditë kalendarike përpara zhvillimit të tij.

14.1.3 Për çdo aktivitet të edukimit në vazhdim bëhet një aplikim i veçantë.

14.1.4 Procedurat e akreditimit për aktivitetet që kryhen nga institucionet publike për punonjësit e vet janë pa pagesë.

14.2 Vlerësimi i brendshëm

14.2.1 Vlerësimi i brendshëm kryhet nga vetë institucioni ofrues i aktivitetit të edukimit në vazhdim dhe shërben si bazë për vlerësimin e jashtëm. Ai identifikon nevojat për edukim në vazhdim dhe metodat më të mira për përmbushjen e tyre. Të dhënat e ofruara nga aplikuesi duhet të pasqyrojnë me vërtetësi informacione për tre komponentët kryesorë, që janë:

14.2.1.1 Qëllimi dhe objektivat e aktivitetit të edukimit në vazhdim, të cilët paraqiten nëpërmjet një deklaratë të shkruar, duke përfshirë dhe fushat e ndërhyrjes, audiencën, së cilës i drejtohet, llojin e aktivitetit që do të ofrohet dhe rezultatet e pritshme nga ky aktivitet;

14.2.1.2 Planifikimin e aktivitetit, ku ofruesi:

i) duhet të demonstrojë një proces planifikimi të aktivitetit, i cili gërsheton nevojat e identifikuara për edukim në vazhdim me rezultatet e parashikuara të aktivitetit;

ii) duhet të përdorë të dhëna të bazuara në vlerësimin e nevojave për hartimin dhe planifikimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim;

iii) duhet të komunikojë qëllimin dhe objektivat e aktivitetit, në mënyrë që profesionistët pjesëmarrës të jenë në dijeni të tyre para ofrimit të aktivitetit;

iv) duhet të sigurojë përputhje me politikat e parashikuara për mbështetjen financiare dhe konfliktin e interesit.

14.2.1.3 Vlerësimin dhe përmirësimin e aktivitetit, ku ofruesi:

i) duhet të ketë parashikuar vlerësimin e efikasitetit të aktivitetit të edukimit në vazhdim në përmbushjen e nevojave të identifikuara paraprakisht;

ii) duhet të bëjë përmirësimet e nevojshme, të sugjeruara nga procesi i vlerësimit.

14.3 Vlerësimi i jashtëm

14.3.1 Vlerësimi i jashtëm kryhet nga KEVP-ja dhe realizohet nëpërmjet vlerësimit të dokumentacionit para akreditimit dhe monitorimit të aktivitetit/vlerësimit përfundimtar. Në fazën e parë, që kryhet para se aktiviteti të akreditohet dhe zbatohet, ndiqen procedurat e mëposhtme:

14.3.1.1 KEVP-ja shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesi dhe, nëse ai është i plotë, bën vlerësimin e tij sipas kritereve të cilësisë në planifikimin e aktivitetit, përfshirë vlerësimin e burimeve të përdorura (trajnerët, materialet pedagogjike) dhe përgatit raportin përkatës. Në rast të plotësimit të pjesshëm nga ofruesit, të dokumentacionit të kërkuar, KEVP-ja ruan të drejtën e refuzimit të akreditimit ose mosvlerësimit me kredite, për ato materiale të programit që kanë mangësi në dokumentacion;

14.3.1.2 KEVP-ja ngarkon një ose më shumë ekspertë të pavarur të fushës, për të kryer vlerësimin e përmbajtjes së kurrikulave që do të përdoren në aktivitet dhe për përputhshmërinë e tyre me nevojat e pjesëmarrësve. Në varësi të këtij vlerësimi, eksperti/ekspertët mund të sugjerojnë se cilat tema duhen konsideruar ose jo në llogaritjen e krediteve. Eksperti përgatit raportin përkatës. Për aktivitete që përdorin materiale trajnuese, të hartuara nga EFPA apo organizma/ente ndërkombëtare, me të cilat Urdhri i Psikologut ka marrëveshje paraprake apo është anëtare, KEVP-ja mund të mos i kalojë këto materiale për vlerësimin e ekspertit të pavarur të fushës;

15. Ekspertët e pavarur

15.1 Ekspertët që do të përfshihen në vlerësimin e jashtëm të një aktiviteti të edukimit në vazhdim zgjidhen sipas fushës përkatëse, me rotacion, nga lista e ekspertëve e miratuar nga KVEP. Lista e ekspertëve rishqyrtohet çdo dy vjet. Kriteret për të qenë ekspertë përcaktohen nga KVEP dhe duhet të kenë eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet.

15.2 Ekspertët e përfshirë në procesin e vlerësimit të jashtëm të një aktiviteti të edukimit në vazhdim duhet të deklarojnë, para përpilimit të raportit, çdo konflikt të mundshëm interesi me ofruesin e aktivitetit të edukimit në vazhdim. Gjithashtu, eksperti i përzgjedhur për vlerësimin e jashtëm të një aktiviteti nuk duhet të jetë i përfshirë në planifikimin, organizimin dhe zbatimin e aktivitetit që vlerësohet prej tij.

15.3 Urdhri i Psikologut paguan ekspertët e pavarur për vlerësimin e kryer prej tyre, sipas kësaj rregulloreje.

15.4 Bazuar në dy raportet e vlerësimit, atij të brendshëm dhe të jashtëm, KEVP-ja vendos nëse aktiviteti akreditohet ose jo dhe përcakton numrin e krediteve për aktivitetin që do të akreditohet;

15.5 Dokumentacioni i vlerësimit të brendshëm dhe ai i vlerësimit të jashtëm, së bashku me numrin e përcaktuar të krediteve, bazuar në llojin e aktivitetit dhe kohëzgjatjen e tij, përbëjnë dosjen e vlerësimit.

16. Publikimi i rezultateve dhe përcaktimi i krediteve

16.1 Pas vlerësimit të jashtëm, KEVP-ja merr vendimin e akreditimit ose jo të një aktiviteti. KEVP-ja bën të ditur vendimin e saj brenda 30 ditëve, pas plotësimit të dokumentacionit për akreditim nga ana e ofruesit.

16.2 Në rastet kur akreditimi refuzohet, aplikuesit duhet t'i kthehet një përgjigje me shkrim nga KEVP-ja, duke paraqitur arsyet e refuzimit dhe sugjerimet përkatëse për përmirësimin e planifikimit dhe hartimit të propozimeve të ardhshme.

16.3 Aktivitetet, të cilat akreditohen, si dhe kreditet përkatëse të tyre, i bëhen të njohura ofruesit dhe publikohen në faqen e internetit të Urdhrit të Psikologut.

16.4 Akreditimi i një aktiviteti është i vlefshëm për një periudhë dy vjeçare, nga momenti i akreditimit fillestar.

17 Monitorimi dhe vlerësimi përfundimtar

Ofruesi i akredituar duhet të njoftojë KEVP-në 5 (pesë) ditë pune përpara zhvillimit të aktivitetit për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të tij.

17.1 KEVP-ja ka të drejtë të monitorojë aktivitetin e edukimit në vazhdim, të akredituar ose në proces, për të siguruar zbatimin e standardeve dhe kritereve të parashikuara. KEVP-ja ka të drejtë të monitorojë në mënyrë të rastësishme dhe pa njoftim paraprak aktivitetet që akreditohen prej saj. Gjithashtu, KEVP-ja ka të drejtë të realizojë vlerësimin e aktivitetit nga pjesëmarrësit në aktivitet.

17.2 Pas përfundimit të aktivitetit, aplikuesi duhet të plotësojë dosjen e vlerësimit, duke dorëzuar pranë KEVP-së listën e pjesëmarrësve në aktivitet dhe rezultatet e procesit të vlerësimit të aktivitetit.

17.3 KEVP-ja mund të anulojë akreditimin e ofruar apo të rishikojë numrin e krediteve kur vërehen shkeljet e mëposhtme:

17.3.1 Ndryshime në programin e aktivitetit, të cilat çenojnë cilësinë e tij dhe ndikojnë në përlllogaritjen e krediteve të miratuara;

17.3.2 Mosraportimi i konflikteve të interesit të organizatorëve ose/dhe trajnuesve në aktivitet;

17.3.3 Përdorimi i aktivitetit për promovim personal ose tregtar;

17.3.4 Keqpërdorimi i emrit të institucionit akreditues dhe krediteve të njohura prej tij;

17.3.5 Mosplotësimi i dosjes me dokumentacionin e nevojshëm për fazën pas aktivitetit;

17.3.6 Vlerësimi negativ i shumicës së pjesëmarrësve për organizimin e aktivitetit, përmbajtjen e temave të veçanta ose nivelin pedagogjik të paraqitjes së këtyre temave;

17.3.7 Shkelje të kritereve të përshkruara në pikat 14.1.2 dhe 14.1.3 të kësaj rregulloreje.

17.3.8 Mosdeklarim i mbështetjes financiare ose deklarim i rremë në aplikimin për akreditim.

17.3.11 Në rast se gjatë monitorimit të aktivitetit vihet re përmbushje maksimale e standardeve të cilësisë dhe/ose vlerësim i shkëlqyer i programit, lektorëve/trajnerëve dhe organizimit të aktivitetit nga pjesëmarrësit, KEVP-ja mund të bëjë një rritje deri në 20% të numrit të krediteve të miratuara paraprakisht për aktivitetin e monitoruar. Këtu përjashtohen aktivitetet ku numri i pjesëmarrësve në sallë është më i madh se 200 veta.

18. E drejta e ankimit

18.1 Ofruesit e aktiviteteve të edukimit në vazhdim kanë të drejtë të ankohen pranë KEVP-së, për vendimin e akreditimit të aktivitetit dhe numrin e krediteve, brenda 30 ditëve nga momenti i marrjes dijeni të njoftimit.

18.2 Çdo ankesë duhet të paraqitet me shkrim dhe të shoqërohet me të dhëna e argumente që mbështetin ankimin. KEVP-ja rishqyrton dosjen e vlerësimit dhe, kur ankesat janë të mbështetura, i reflekton në raportin përfundimtar.

18.3 Në rastet kur ofruesi nuk është dakord me raportin përfundimtar, ai ka të drejtën e ankimit pranë Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni të njoftimit të vendimit nga KEVP-ja.

19. Kriteret e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm

19.1 Ofruesi duhet të paraqesë një deklaratë të qëllimit të aktivitetit të edukimit në vazhdim, e cila duhet të përmbajë të gjithë komponentët bazë (objektivat, fushat që do të përfshijë, llojin e aktivitetit, rezultatet e pritshme), ku rezultatet të jenë formuluar bazuar në termat e ndryshimeve që aktiviteti do të sjellë në njohuritë ose praktikën e profesionistëve.

19.2 Ofruesi duhet të përcaktojë se cilat nevoja për edukim në vazhdim, të shprehura në njohuri, kompetenca ose praktika, do të adresohen në aktivitetin e propozuar të edukimit në vazhdim.

19.3 Ofruesi duhet të hartojë aktivitete, të cilat kanë për qëllim të ndryshojnë njohuritë, aftësitë dhe performancën e psikologut, të parashikuara në qëllimin e deklaruar të aktivitetit.

19.4 Ofruesi duhet të hartojë aktivitete, përmbajtja e të cilave të përputhet me fushën në të cilën psikologët pjesëmarrës ushtrojnë profesionin e tyre.

19.5 Ofruesi duhet të zgjedhë forma edukimi (metoda pedagogjike), të cilat janë të përshtatshme për tematikën, objektivat dhe rezultatet e pritshme të aktivitetit.

19.6 Ofruesi duhet të hartojë aktivitete që përputhen me tematikën e kompetencave të dëshiruara nga profesionistët.

19.7 Ofruesi duhet të organizojë aktivitete të pavarura nga interesat tregtare.

19.8 Ofruesi duhet të menaxhojë, në mënyrë të përshtatshme mbështetjen (financimin, fondet) tregtare.

19.9 Ofruesi duhet ta mbajë të ndarë promovimin tregtare nga pjesa edukative e aktivitetit.

19.11 Për aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm në distancë, ofruesi:

19.11.1 duhet të deklarojë formatin e nevojshëm për përdorimin e materialit (p.sh., Windows/MacOS; lexues DVD) dhe të ofrojë detaje për kontaktet për ofrim mbështetjeje (teknike) për pjesëmarrësit, në rastin e aktiviteteve që përdorin teknologjinë e informacionit, hardëar-in dhe softëar-in që nevojitet për të përdorur materialet, dhe instruksione për përfitimin optimal nga kursi;

19.11.2 duhet të deklarojë kohëzgjatjen në orë të kohës që pjesëmarrësit do t'i duhet për të përmbushur objektivat edukativë të aktivitetit;

19.11.3 duhet të ofrojë mbështetje teknike për pjesëmarrësin, në lidhje me ndjekjen e aktivitetit;

19.11.4 duhet të garantojë një mënyrë për konfirmimin e përfshirjes së pjesëmarrësit, si dhe të përmbushjes së objektivave edukativë;

19.11.5 duhet të respektojë e të konfirmojë konfidencialitetin e pjesëmarrësit, si dhe faktin që çdo informacion, për pjesëmarrësit në aktivitet, do të përdoret vetëm për qëllimet specifike të përmbushjes së kërkesave të këtij materiali. Rastet e vetme të përjashtimit duhet të jenë me informimin dhe miratimin e plotë të pjesëmarrësit.

19.11.6 Duhet të ketë statusin ofrues i akredituar nga KEVP-ja ose nga një institucion i huaj anëtarë i EFPA-s apo organizatave ndërkombëtare ku Urdhri i Psikologut është pjesë. Në rastet kur nuk është i akredituar, ofruesi duhet të ketë një marrëveshje me një ofrues të akredituar nga KEVP-ja.

19.12 Për aktivitetet E-Learning:

19.12.1 Ofruesi duhet të sigurojë përdorimin e materialeve didaktike në mënyrë të vazhdueshme dhe të përsëritshme, me anë të teknologjive multimediale, nëpërmjet lidhjes me internetin;

19.12.2 Ofruesi duhet të përdorë një platformë teknologjike, e cila i dedikohet edukimit dhe garanton përdorimin pa pasur nevojë për orare të caktuara apo të qenit të pranishëm në vende të përcaktuara që më parë;

19.12.3 Platforma teknologjike duhet të garantojë përdorimin e lehtë të kurseve, regjistrimin e përdoruesve, mundësinë për dhënien e pëlqimit për privatësinë dhe trajtimin e të dhënave të përdoruesve, verifikimin e veprimeve të kryera nga përdoruesit në

platformë dhe të jetë në gjendje të masë nivelin e përvetësimit të kurseve nga përdoruesit nëpërmjet testeve vlerësuese dhe testeve për shkallën e pëlqimit të çdo kursi edukues;

19.12.4 Platforma teknologjike duhet të parashikojë një apo më shumë module të edukimit/të formimit, si dhe procese të ndërmjetme vetëvlerësimi;

19.12.5 Verifikimi i pjesëmarrjes duhet të sigurohet me anë të testeve për lëndët e dhëna dhe duhet të garantohet nga kontrolli i veprimeve të kryera nga sistemi. Përveç këtyre, duhet të parashikohen edhe verifikime të veçanta të identitetit të psikologut.

19.13 Për aktivitetet e edukimit në distancë, sinkron (të njëkohshëm), pjesëmarrja në leksione ose sesione edukuese, që zhvillohen larg vendit ku është psikologu, duhet të arrihet nëpërmjet përdorimit të një platforme multimediale të dedikuar (klasa virtuale, ëebinar), nëpërmjet lidhjes me internetin. Pjesëmarrja e njëkohshme duhet të parashikojë lidhjen në internet të pjesëmarrësve në orare të caktuara që më parë nga programi mësimor dhe të garantojë një nivel të lartë ndërveprimi ndërmjet lektorëve/tutorëve dhe pjesëmarrësve. Çdo orë mësimi, përfshirë edhe ndërhyrjet e pjesëmarrësve, duhet të regjistrohet dhe të jetë e disponueshme për t'u verifikuar, përdorur apo përsëritur në një moment tjetër. Pjesëmarrja individuale në aktivitet duhet të verifikohet me anë të regjistrimit të lidhjeve online në platformë gjatë orës së mësimit. Verifikimi i dijeve duhet të bëhet nëpërmjet testit që kryhet në përfundim të sesionit.

19.11.9 Ofruesi duhet të analizojë ndryshimet te pjesëmarrësit (njohuritë, praktikat ose përfitimet e pacientëve), të arritura si rezultat i të gjitha aspekteve të aktivitetit të edukimit në vazhdim.

19.11.11 Ofruesi duhet të identifikojë, planifikojë dhe zbatojë ndryshimet e nevojshme ose të dëshiruara në aktivitet (p.sh., planifikuesit, trajnuesit, infrastrukturën, metodat, burimet, mjetet, ndërhyrjet), që janë të nevojshme për përmirësimin e cilësisë së aktiviteteve të ardhshme të edukimit në vazhdim.

19.11.13 Për aktivitetet e edukimit në distancë, ofruesi duhet të vërtetojë një përvetësim nga pjesëmarrësit deri në 70% të njohurive të reja nga ndjekja e aktivitetit të edukimit në distancë (përqindja kaluese).

19.11.14 Ofruesi duhet të sigurojë përkthim për pjesëmarrësit në rastet kur aktiviteti apo një pjesë e tij zhvillohet në gjuhë të huaj.

20. Kriteret për mbështetjen financiare

20.1 KEVP-ja nuk pranon kërkesa për akreditim të aktiviteteve të edukimit në vazhdim nga subjekte që prodhojnë ose tregtojnë instrumenta, të cilat përdoren nga psikologët, të cilët, në kuptim të kësaj rregulloreje, do të konsiderohen palë të interesit tregtar.

Këta të fundit, mund të mbështetin financiarisht aktivitete të edukimit në vazhdim vetëm kur plotësojnë kriteret e mëposhtme:

20.1.2 Ofruesi i aktiviteteve të edukimit në vazhdim duhet të garantojë se vendimet që do të merren në secilën prej fushave të mëposhtme do të jenë të pavarura dhe nuk do të jenë nën ndikimin e palëve me interes tregtar.

20.1.3 Përdorimi i duhur i mbështetjes tregtare

20.1.3.1 Ofruesi duhet të marrë të gjitha masat për sigurimin e mbështetjes financiare.

20.1.3.2 Ofruesi nuk duhet të detyrohet nga pala e interesit tregtar për të marrë këshilla apo shërbime që lidhen me lektorët, autorët, pjesëmarrësit apo çështjet e edukimit, përfshirë këtu edhe përmbajtjen, si kusht i marrjes së fondeve.

20.1.3.3 E gjithë mbështetja financiare për aktivitetin e edukimit në vazhdim duhet të menaxhohet vetëm nëpërmjet ofruesit (institucionit që ka bërë kërkesën për akreditim pranë institucionit akreditues).

20.1.4 Administrimi i duhur i promocionit tregtar

20.1.4.1 Marrëveshjet për prezantimet tregtare ose publiciteti nuk duhet të influencojnë në planifikimin ose në implementimin e një aktiviteti të edukimit në vazhdim dhe as nuk mund të jenë kusht për ofrimin e mbështetjes financiare për aktivitetin.

21. Paguesa e kryer nga ofruesi, gjatë fazës së aplikimit, mbulon shpenzimet operative të KEVP-së gjatë procedurave të vlerësimit të aktivitetit të edukimit në vazhdim dhe është e pavarur nga vendimi për miratim ose jo të akreditimit për aktivitetin.

XI. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

22.1 Secili nga anëtarët e Komisionit të Edukimit në Vazhdim paguhen me honorare, bazuar në numrin e mbledhjeve. Pavarësisht nga cilësia e anëtarëve, secili prej tyre paguhet në vlerën neto 15 000 Lekë/mbledhje.

22.2 Secili nga ekspertët që përfshihet në procesin e akreditimit paguhet me honorare në vlerën neto sipas llojit të aktevitetit si më poshtë:

30 000 lekë për cdo proces vlerësimi të një konference

25 000 lekë për cdo proces vlerësimi të një trajnimi

15 000 lekë për cdo proces vlerësimi të prezantimi të një leksioni

20 000 lekë për cdo proces vlerësimi të çdo lloj tjetër aktiviteti të edukimit në vazhdim

XII. TARIFAT E AKREDITIMIT PËR OFRUESIT E EDUKIMIT NË VAZHDIM

23. Cdo aplikim për akreditim shoqërohet me pagesën e një tarife në vlerën 200 lekë për cdo kredit që kërkohet për akreditim, por jo më të vogël se 30 000 lekë.

24. Dispozitë kalimtare

Psikologët e licencuar deri ne momentin e daljes së kësaj rregulloreje rilicencohen me plotësimin e numrit të përgjithëm prej 80 kredite për të gjithë periudhën deri në momentin e rilicencimit.